

trainkos

HEKURUDHAT E KOSOVËS TRAINKOS SH. A.

2018

RAPORT GJASHTËMUJOR

Janar - Qershor 2018



**FUSHË KOSOVË,
Korrik 2018**

PËRMBAJTJA

I.	HYRJE	4
II.	STRUKTURA ORGANIZATIVE E HK – TRAINKOS SH. A.	5
III.	TREGUESIT E RAPORTIT FINANCIAR	7
III. 1.	Gjendja financiare Janar – Qershor 2018	7
III. 2.	Të hyrat	7
III. 3.	Shpenzimet	8
III. 4.	Të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën Janar – Qershor 2018	9
III. 5.	Gjendja në para të gatshme – Raporti sipas bankës (30.06.2018)	11
III. 6.	Transaksionet e realizuara janar – qershor 2018	12
IV.	DEPARTAMENTI I TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE	13
IV. 1.	Pasqyra e performancës operative	13
IV. 2.	Organizimi dhe realizimi i transportit të udhëtarëve	13
IV. 3.	Numri i trenave, tren kilometër (T/km) dhe udhëtarë kilometër (U/km)	14
IV. 4.	Vonesa e trenave të udhëtarëve	14
V.	DEPARTAMENTI I TRANSPORTIT TË MALLRAVE	15
V.1.	Pasqyra e performancës operative	15
V.2.	Rezultatet e arritura nga transporti i mallrave	15
V.3.	Shfrytëzimi i trenave	16
V.4.	Efikasiteti i trenave	17
V.5.	Neto Ton & Neto Ton kilometër të transportuar	17
V.6.	Mallrat e transportuara	17
VI.	ZYRA E MIRËMBAJTJES SË MJETEVE LËVIZËSE – MML	18
VI.1.	Pasqyra e performancës operative	18
VI.2.	Spektori i mirëmbajtjes	18
VI.2.1.	Mirëmbajtja e trenave motorikë - TM	18
VI.2.2.	Mirëmbajtja e trenave motorikë – matja e produktivitetit	19
VI.2.3.	Mirëmbajtja e trenave motorikë – matja e efikasitetit	19
VI.2.4.	Mirëmbajtja e lokomotivave manovruese	19
VI.2.5.	Mirëmbajtja e lokomotivave manovruese – matja e produktivitetit	19
VI.2.6.	Mirëmbajtja e lokomotivave manovruese – matja e efikasitetit	20
VI.3.	Mirëmbajtja e lokomotivave transportuese	20
VI.3.1.	Mirëmbajtja e lokomotivave transportuese – matja e produktivitetit	20
VI.3.2.	Mirëmbajtja e lokomotivave transportuese – matja e efikasitetit	20
VI.4.	Mirëmbajtja e vagonëve për transportin e udhëtarëve	21
VI.4.1.	Mirëmbajtja e vagonëve për transportin e udhëtarëve - matja e produktivitetit	22
VI.4.2.	Mirëmbajtja e vagonëve për transportin e udhëtarëve - matja e efikasitetit	22
VI.5.	Mirëmbajtja e vagonëve për transportin e mallrave	22
VI.5.1.	Mirëmbajtja e vagonëve për transportin e mallrave - matja e produktivitetit	23
VI.5.2.	Mirëmbajtja e vagonëve për transportin e mallrave - matja e efikasitetit	23
VI.6.	Faturimi për riparimin e vagonëve të huaj për periudhën Janar – Qershor 2018	23

VI.7.	Shpenzimi i vajrave për periudhën Janar – Qershor 2018	23
VI.8.	Buxheti	24
VII.	PROJEKTET KAPITALE	25
VIII.	KONTESTET GJYQËSORE	26
VIII.1.	Kontestet për kompensim dëmi	26
VIII.2.	Aktgjykimet	26
VIII.3.	Kontestet për pagim borxhi	27
VIII.4.	Aktgjykimet	27
VIII.5.	Aktvendimet	27
VIII.6.	Kontestet e punës	27
VIII.7.	Aktgjykimet	28
VIII.8.	Aktvendimet	28
VIII.9.	Lëndët përmbare	28
VIII.10.	Aktvendimet	29
IX.	AKTIVITETET NË PLANIFIKIMIN DHE ZHVILLIMIN E BIZNESIT	30
IX.1.	Planifikimi dhe zhvillimi i biznesit	30
IX.2.	Koordinimi i proceseve me ARH-në dhe institucionet tjera	32
IX.3.	Aktivitetet e marketingut	32
IX.4.	Raportimi i rregullt vjetor në asociacionet tjera hekurudhore	33
X.	SFIDAT KRYESORE GJATË PERIUDHËS JANAR – QERSHOR DHE VEPRIMET PËR TË ARDHMEN	34

I. HYRJE

Raporti për periudhën Janar - Qershor për vitin 2018, për HK - Trainkos SH. A. është karakterizuar kryesisht më përpjekjen e të gjitha niveleve organizative të kompanisë duke filluar nga Bordi i Drejtorëve, Menaxhmenti e deri te stafi ekzekutiv për arritjen e rezultateve më pozitive në kushtet dhe mundësitë ekzistuese.

Ky raport paraqet qartë aktivitetet gjatë këtij gjashtëmujori në funksion të arritjes së objektivave të vendosura me Planin e Biznesit. Po ashtu ky raport pasqyron vështirësitë dhe sfidat gjatë zhvillimit të aktivitetit të kompanisë për këtë gjashtëmujor, sfida këto që përcillen nga vitet paraprake e që ndikojnë drejtpërdrejt në mos arritjen e planifikimeve.

Sfidat për këtë periudhë kanë qenë nga më të ndryshmet, duke u përballur me të gjitha vështirësitë që vijnë si rezultat i mungesës së kërkesës në treg, veçanërisht atyre të mallrave dhe në anën tjetër me një konkurrencë të egër nga operatorë të transportit rrugorë të mallrave. Po ashtu sfida në vete mbetet edhe mosrealizimi i planifikimit të deklaruar nga klienti ynë kryesor “NewCo Feronikeli” në transportin e mallrave, i cili vazhdon të përballlet me vështirësi të shumta në operim.


Vonesat në arritjen e marrëveshjes për Obligimet e Shërbimeve ndaj Publikut (OSHP) me Ministrinë e Infrastrukturës kanë krijuar vështirësi të theksuara edhe në këtë gjashtëmujor. Megjithatë është një e arritur e madhe në këtë drejtim pasi që marrëveshja tani është nënshkruar për një periudhë pesëvjeçare.

Përpjekjet tona në ofrimin e shërbimeve sa më cilësore si për klientët ashtu edhe për bizneset do të jenë prioriteti ynë. Në tremujorin e fundit të vitit të kaluar është realizuar projekti për furnizim me dhjetë vagonë të udhëtarëve të cilët kanë ndikuar në ofrimin e kushteve shumë më të mira për udhëtarë, ndërsa në këtë vit pritjet të zhvillohen procedurat për furnizim me një tren motorik. Gjithashtu është më e rëndësishme të theksohet se projekti për rinovimin e objektit administrativ është në përfundim e sipër, i cili do të ndikojë në krijimin e kushteve edhe më të mira për stafin e ndërmarrjes.

Përkundër projekteve të theksuara më lart, të cilat janë realizuar me mjetet e ndara nga Aksionari për projektet kapitale, nevoja për investime ende vazhdon të mbetet sfida në vete pasi që pothuajse të gjitha mjetet lëvizëse janë tejet të vjetruara përderisa investimet janë shumë të kufizuara për të bërë përtëritjen e tyre.

II. STRUKTURA ORGANIZATIVE E HK – TRAINKOS SH. A.

Hekurudhat e Kosovës -Trainkos SH. A. brenda periudhës gjashtëmujore janar – qershor 2018 në numrin e përgjithshëm të të punësuarve ka pasur disa ndryshime të cilat kanë reflektuar edhe në përqindjen e strukturës së përgjithshme të të punësuarve. Në tabelën në vijim do të paraqesim gjendjen e të punësuarve në Kompani nga data 01.01.2018 deri më 30.06.2018, duke filluar nga numri i përgjithshëm i të punësuarve, mosha mesatare, punëtorët me kontrata të afatizuara dhe të paafatizuara etj.



Paraqitja statistikore për llojet e kontratave, mosha e të punësuarve, struktura gjinore, struktura nacionale dhe kualifikimi shkollor i të punësuarve në HK-Trainkos - Sh. A. është si vijon:

Struktura e të punësuarve në bazë të kategorizimeve të HK-Trainkos-SH.A. më 1 janar 2018 dhe më 30 qershor 2018				
Totali i të punësuarve	01.01.2018		30.06.2018	
	233		230	
Vlerat	Vlerat në numra		Vlerat në përqindje	
Datat	01.01.2018	30.06.2018	01.01.2018	30.06.2018
Mosha mesatare e punëtorëve	46.70	47.16	%	%
Me marrëdhënie të rregullt pune	233	230	%	%
Me kontratë të paafatizuar	105	105	45.06 %	45.06 %
Me kontratë të afatizuar	128	125	54.93 %	54.34%
Meshkuj	208	205	89.27 %	89.13 %
Femra	25	25	10.72 %	10.86%
Serbë	2	2	0.85 %	0.86 %
Shqiptarë	231	228	99.14 %	99.13 %
Me shkollim fillor	16	16	6.86 %	6.95 %
Me shkollim të mesëm	127	125	54.50 %	54.34 %
Kualifikim profesional	24	24	10.30 %	10.43 %
Me shkollim të lartë	4	4	1.71 %	1.73 %
Me shkollim superior	63	61	27.03 %	26.52 %
Departamenti i Operimeve	140	-	60.08%	
Departamenti i Transportit të Mallrave	-	47	-	20.43 %
Departamenti i Transportit të Udhëtarëve	-	64	-	27.39 %
Departamenti i Administratës	39	39	16.73%	16.95 %
Departamenti i Financave	10	10	4.29%	4.34 %
Departamenti i Zhvillimit	7	7	3.0%	3.04 %
Departamenti i Prokurimit	4	4	1.71	1.73%
Kabineti i KE-së	5	5	2.14%	2.17 %
Zyra e Kontrollit, Sigurisë dhe Kualitetit	20	20	8.58%	8.69 %
Zyra për Marrëdhënie me Publikun	4	4	1.71%	1.73 %
Zyra Ligjore	4	4	1.71%	1.73%
Zyra e për Mirëmbajtjen e Mjeteve Lëvizëse	-	27	-	11.73 %

Tabela Nr. 2.1

Sqarim:

- Totali i të punësuarve më 01.01.2018 është 233 të punësuar.
- Totali i të punësuarve më 30.06.2018 është 230 të punësuar.

Në muajin shkurt 2018 është bërë ndarja e Departamenti të Operimeve në Departamentin e Transportit të Mallrave, Departamentin e Transportit të Udhëtarëve dhe Zyrën për Mirëmbajtjen e Mjeteve Lëvizëse.

Vërejtje: Në tabelën e paraqitur më lart nuk janë përfshirë anëtarët e Bordit të Drejtorëve dhe punëtorët me kontrata për punë specifike.

III. TREGUESIT E RAPORTIT FINANCIAR

III.1. Gjendja financiare Janar - Qershor 2018

Për periudhën raportuese janar – qershor 2018, gjendja e pozicioneve të të hyrave dhe shpenzimeve është siç vijon:

III.2. Të Hyrat

Nga **Transporti i mallrave** kemi realizuar të hyrat prej 151,463.60€ për periudhën janar - qershor 2018. Totali i të hyrave të planifikuara për këtë gjashtëmujor është 602,661€ dhe nga kjo del se kemi realizuar 25.13% të planifikimit. Të hyrat nga transporti i mallrave eksport/import janë realizuar sipas kategorive që pasojnë: të hyrat nga importi i kemi realizuar përmes vijës kufitare Hani i Elezit në shumën prej 38,986.62€ dhe nga eksporti po ashtu përmes vijës kufitare Hani i Elezit kemi realizuar shumën prej 2,765.61€. Transporti i brendshëm kryesisht është realizuar për “NewCo Ferronikeli” dhe atë në transportin e xehes nga Medveci dhe thëngjillit nga Kastrioti. Në këtë periudhë nga ky lloj i transportit është realizuar shuma prej 109,711.41€.

Transporti i udhëtarëve për periudhën janar – qershor 2018, është realizuar në shumën prej 893,847.04€. Nga të hyrat e faturuara nga Transporti i Kontraktuar janë 599,687.80€, nga të hyrat e planifikuara nga subvencionimi për mbulimin e pjesës së humbjeve nga trenat tjerë të udhëtarëve kemi realizuar shumën prej 249,999.96€. Burimi i të ardhurave nga biletat është realizuar në shumën prej 44,159.33€, shprehur në përqindje me realizimin e të hyrave nga transporti i udhëtarëve kemi arritur shumën e realizimit prej 32.90%, krahasuar me planifikimet e vitit 2018 – 2,716,793.00€.

Të hyrat nga shërbimet tjera gjatë periudhës janar - qershor 2018, kanë arritur shumën prej 9,090.15€. Kjo shumë nëse krahasohet me shumën e buxhetuar për vitin 2018, e cila është 40,000.00€ arrin kuotën prej 22.73%. Kjo e hyrë është realizuar në pozicionin të hyrat nga RIV-i dhe vendosjet.

Të hyra tjera të cilat janë realizuar gjatë periudhës janar – qershor 2018, kanë arritur shumën prej 26,012.44€. Kjo e hyrë është realizuar në pozicionet siç vijojnë: Të hyrat nga shitja e derivateve për HK-Infrakos Sh. A. – 21,033.49€, të hyrat nga riparimi i vagonëve të dëmtuar në vlerë prej 3,661.11€ dhe të ardhurat nga zbritjet e marra 1,317.85€. Buxheti i planifikuar është 26,012.44€, shprehur në përqindjen 26.01%.

III.3. Shpenzimet

Shpenzimet për periudhën janar – qershor 2018, ashtu edhe siç janë buxhetuar janë të klasifikuara në kategoritë që pasojnë:

Totali i kostos së shërbimit për periudhën është 383,903.77€ nga 1,628,500.00€ të planifikuara për vitin 2018 dhe arrin kuotën prej 23.57%. Shpenzimet sipas grupimeve në kode të posaçme janë të precizuara në tabelën më poshtë – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën janar – qershor 2018.

Shpenzimet e stafit është kategori tjetër e rëndësishme e cila ka arritur shumën prej 842,264.40€, dhe atë në paga dhe kontribute – 839,675.79€ dhe sigurimi shëndetësor, trajnime dhe shpenzime tjera – 2,588.61€. Në total nëse e krahasojmë me shumën e buxhetuar për vitin 2018 – 1,810,000.00€, në këtë kategori kemi arritur kuotën prej 46.53%.

Totali i shpenzimeve operative kap shumën prej 47,085.57€, kjo shumë është 3.55% nga shuma prej 1,326,200.00€ e parashikuar vitin 2018. Edhe kjo kategori e shpenzimeve sipas grupimeve në kode të posaçme është e precizuar në tabelën e më poshtme – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën janar – qershor 2018.

Totali i shpenzimeve administrative ka arritur në kuotën prej 10.96%, konkretisht në shumën prej 26,126.51€. Planifikimi për vitin 2018, i kësaj kategorie është 238,414.23€. Shpenzimet sipas grupimeve në kode të posaçme janë të precizuara në tabelën e mëposhtme – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën janar – qershor 2018.


III.4. Të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën janar - qershor 2018

	EMËRTIMI	Realizimi Janar- Qershor 2018	Buxheti 2018	Diferenca	B/C (%)	Realizimi Janar – Qershor 2017
	A	B	C	D	E	F
A	Shitjet					
1	Transporti i mallrave	151,463.64	1,205,323.23	(1,053,859.59)	12.57	463,358.91
2	TU – Ministria e Infrastrukturës	599,687.80	1,967,292.50	(1,367,604.70)	30.48	957,481.57
3	TU – Ministria e Zhvillimit Ekonomik	249,999.96	500,000.00	(250,000.04)	50.00	249,999.96
4	TU – Shitja e Biletave	44,159.33	249,500.50	(205,341.17)	17.70	85,676.26
5	Shërbimet tjera	9,090.15	40,000.00	(30,909.85)	22.73	17,650.00
6	Të ardhurat – Dëmtimi i vagonëve	3,661.11	50,000.00	(46,338.89)	7.32	9,133.49
7	Të hyrat tjera jo operative	21,033.49	50,000.00	(28,966.51)	42.07	22,333.95
I	TOTAL – TË HYRAT	1,079,095.48	4,062,116.23	(2,983,020.75)	26.56	1,805,634.14
B	Kostoja e shërbimit/blerjes së materialeve					
1	Derivatet dhe lubrifikantet	180,181.79	765,000.00	(584,818.21)	23.55	366,810.34
2	Energjia elektrike dhe shërbimet tjera komunale	4,907.31	35,000.00	(30,092.69)	14.02	28,780.69
3	Inventar dhe pajisje	-	3,500.00	(3,500.00)	0.00	665.31
4	Material harxhues	198.69	1,500.00	(1,301.31)	13.25	-
5	Pjesë rezervë/mirëmbajtje dhe materiale tjera	6,519.51	72,500.00	(65,980.49)	8.99	18,028.98
6	Qasja në binarë	164,838.72	650,000.00	(485,161.28)	25.36	317,834.65
7	Sigurimi i palëve të treta	1,977.97	6,000.00	(4,022.03)	32.97	1,627.59
8	Tërheqja e trenave dhe qiraja e vagonëve të huaj	4,093.87	40,000.00	(35,906.13)	10.23	15,481.90
9	Shpenzimet e transportit Infrakos	21,185.91	55,000.00	(33,814.09)	38.52	24,618.20
	TOTAL – KOSTOJA E SHERBIMIT	383,903.77	1,628,500.00	(1,244,596.23)	23.57	773,847.66
	Fitimi (humbja) bruto	695,191.71	2,433,616.23	(1,738,424.52)	28.57	1,031,786.48
	TE ARDHURAT TJERA					
1	Te Ardhura të jashtëzakonshme	-	-	-	0.00	-
2	Zbritjet e mara	1,317.85	-	1,317.85	0.00	9,524.85
3	Te ardhura tjera	-	1,000,000.00	(1,000,000.00)	0.00	-
	TOTAL – Te ardhurat tjera	1,317.85	1,000,000.00	(998,682.15)	0.13	9,524.85
C	Shpenzimet e stafit					
1	Pagat dhe kontributet	839,675.79	1,782,000.00	(942,324.21)	47.12	858,873.89
2	Sigurimi shëndetësor, trajnime dhe Shpenzime tjera	2,588.61	28,000.00	(25,411.39)	9.25	10,573.26
	TOTAL - Shpenzimet e stafit	842,264.40	1,810,000.00	(967,735.60)	46.53	869,447.15
D	Shpenzimet operative					
1	Mirëmbajtje dhe riparime	944.97	1,060,000.00	(1,059,055.03)	0.09	846.72
2	Sigurimi fizik – total	16,326.39	54,000.00	(37,673.61)	30.23	17,176.27
3	Shërbimet tjera	-	500.00	(500.00)	0.00	-


4	Shpenzimet logjistike	6,312.16	17,000.00	(10,687.84)	37.13	8,410.82
5	Energjia elektrike dhe komunalitë	2,591.89	35,000.00	(32,408.11)	7.41	-
6	Sigurimi i palëve të treta	1,860.07	6,000.00	(4,139.93)	31.00	3,136.99
7	Marketingu	1,599.32	36,000.00	(34,400.68)	4.44	2,398.33
8	Udhëtimet zyrtare	50.00	22,000.00	(21,950.00)	0.23	2,013.40
9	Telefonat dhe Posta	8,587.40	33,500.00	(24,912.60)	25.63	12,930.27
10	Shërbimet bankare	482.56	1,200.00	(717.44)	40.21	669.94
11	Tatimet	8,036.25	17,000.00	(8,963.75)	47.27	2999.64
12	Pajisje elektronike	294.56	14,000.00	(13,705.44)	2.10	1,343.41
13	Blerja e automjeteve për nevoja të kompanisë	-	30,000.00	(30,000.00)	0.00	-
	TOTAL - Shpenzimet operative	47,085.57	1,326,200.00	(1,279,114.43)	3.55	51,925.79
E	Shpenzimet administrative			-		
1	Inventar dhe pajisje	-	20,000.00	(20,000.00)	0.00	-
2	Konsulenca dhe auditimi i jashtëm	3,473.73	15,000.00	(11,526.27)	23.16	-
3	Material i zyrës	2,884.80	18,000.00	(15,115.20)	16.03	3,053.66
4	Material sanitar	890.67	9,000.00	(8,109.33)	9.90	1,196.60
5	Qiraja për objektet	3,806.61	10,000.00	(6,193.39)	38.07	3,503.13
6	Reprezentacioni dhe bufeja	1,628.50	10,914.23	(9,285.73)	14.92	1,986.25
7	Shpenzimet gjyqësore dhe ndëshkimet	11,333.20	55,000.00	(43,666.80)	20.61	12,642.00
8	Shpenzimet logjistike	2,099.00	30,500.00	(28,401.00)	6.88	1,095.46
9	Kontingjente	10.00	70,000.00	(69,990.00)	0.01	805.08
	TOTAL - shpenzimet administrative	26,126.51	238,414.23	(212,287.72)	10.96	24,282.18
II	TOTAL -SHPENZIMET (B+C+D+E)	1,299,380.25	5,003,114.23	(3,703,733.98)	25.97	1,719,502.78
III	Fitimi (Humbja) para zhvlerësimit	(218,966.92)	59,002.00	(277,968.92)	371.12	95,656.21
	GRANTET	493,347.89	960,300.00	(466,952.11)	51.37	442,565.71
F	Shpenzimet e zhvlerësimit					
1	Shpenzimet e zhvlerësimit që janë rezultat i granteve	493,347.89	960,300.00	(466,952.11)	51.37	442,565.71
2	Shpenzimet e zhvlerësimit që janë nga buxheti i kompanisë	12,295.54	29,700.00	(17,404.46)	41.40	12,022.17
	TOTAL - shpenzime e zhvlerësimit	505,643.43	990,000.00	(484,356.57)	51.08	454,587.88
G	Fitimi (humbja) nga veprimtaria	(231,262.46)	29,302.00	(260,564.46)	789.24	83,634.04

Tabela Nr. 3.1

Diagrami 1. Pjesëmarrja e të hyrave sipas llojit të shërbimit Janar – Qershor 2018



Diagrami 2. Pjesëmarrja e shpenzimeve sipas kategorive Janar – Qershor 2018



III.5. Gjendja në para të gatshme – Raporti sipas bankës (30.06.2018)

Nr	EMËRTIMI	Saldo 30-06-2018
1	PCB nr. 1114-004229-0001-59	5,660.37
2	PCB (KTh) nr. 1114-004229-0101-50	24,988.00
3	BKK - PCB (K) nr. 1114-004229-0201-41	0.00
4	BKK - PCB (S) nr. 1114-004229-0301-32	1,462.04
5	BKK - PCB (M) nr. 1114-004229-0401-23	86,728.05
6	GH-PCB nr. 1114004229040114	0.00
7	BPB	29,959.46
	Totali	148,797.92

Tabela Nr. 3.2

III.6. Transaksionet e realizuara (janar – qershor) 2018

Në tabelat në vijim janë paraqitur transaksionet e kompanisë në llogaritë rrjedhëse dhe ato në projektet kapitale të financuara nga Buxheti i Kosovës:

Transaksionet e kompanisë në llogaritë rrjedhëse	
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 01.01.2018	10,106.77
Inkasimet e pranuar gjatë muajve janar – qershor 2018	170,540.46
Pagesat e kryera gjatë muajve janar – qershor 2018	174,986.86
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 30.06.2018	5,660.37

Tabela Nr. 3.3

Transaksionet në projektet kapitale të financuara nga Buxheti i Kosovës	
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 01.01.2018	442,211.16
Inkasimet e pranuar gjatë muajve janar – qershor 2018	49,143.65
Pagesat e kryera gjatë muajve janar – qershor 2018	491,354.81
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 30.06.2018	0.00

Tabela Nr. 3.4

IV. DEPARTAMENTI I TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE

IV.1. Pasqyra e performancës operative

Në këtë pjesë të raportit do të paraqesim performancën gjatë periudhës janar - qershor 2018, duke krahasuar atë me realizimin e gjashtë mujorit të parë të vitit 2017.

Pasqyra e realizimit të transportit të udhëtarëve:

- Biletat e shitura:54,568
- Numri i udhëtarëve:.....54,730

Më poshtë paraqesim tabelën nr. 4.1 ku kemi krahasimin e të dhënave të realizuara gjatë kësaj periudhe me të dhënat e periudhës së njëjtë të vitit të kaluar:

	Realizimi në Vitin 2017	Realizimi në Vitin 2018	Ndryshimi në %
Numri i udhëtarëve	108.738	57,730	-49.67 %
Të hyrat nga biletat pa TVSH	85,233.89€	43,302.55€	-49.20 %

Tabela Nr. 4.1

IV.2. Organizimi dhe realizimi i transportit të udhëtarëve

Në tabelën nr. 4.2 janë paraqitur krahasimet e përgjithshme të të dhënave të realizimit të transportit të udhëtarëve në periudhën Janar – Qershor 2018 me periudhën e njëjtë të vitit 2017.

Përshkrimi - Udhëtarë	Janar – Qershor
Realizimi i numrit të udhëtarëve në 2017	108,738
Realizimi i numrit të udhëtarëve në 2018	54,730
Planifikimi i numrit të udhëtarëve në 2018	150,000
Dallimi: Realizim 2018 - 2017	-54,008
Dallimi: Realizim - planifikimi 2018	-95,270
Dallimi në %: 2018 - 2017	-49.67
Dallimi në %: Realizim - Planifikimi 2018	-63.51

Tabela Nr. 4.2

Siç shihet nga shënimet e paraqitura më lart, sa i përket transportit të udhëtarëve për këtë periudhë kohore kemi pasur një numër të udhëtarëve më të vogël krahasuar me vitin e kaluar, me një rënie prej **49.67 %** dhe sipas planifikimit 2018 kemi rënie prej **63.51%**.

Në tabelën më poshtë është pasqyruar realizimi i transportit të udhëtarëve në vlera financiare:

Përshkrimi - të hyrat nga shitja e biletave	Janar – Qershor
Realizimi i të hyrave në 2017	85,233.59
Realizimi i të hyrave në 2018	43,302.55
Planifikimi i të hyrave në 2018	124,750.00
Dallimi: Realizim 2018 - 2017	-41,931.34
Dallimi: Realizim - planifikimi 2018	-81,447.45
Dallimi në %: 2018 - 2017	-49%
Dallimi në %: Realizim - Planifikimi 2018	-65%

Tabela Nr. 4.3

IV.3. Numri i trenave, tren kilometër (T/km) dhe udhëtarë kilometër (U/km)

Numri i trenave të udhëtarëve për gjashtëmujorin e parë të vitit 2018 ka qenë **1,130**.

Të gjithë trenat e udhëtarëve gjatë periudhës gjashtëmujore kanë realizuar **77,485** tren/km.

Për gjashtëmujorin e parë kanë qenë **2,066,848** udhëtarë/kilometër.

IV.4. Vonesat e trenave të udhëtarëve

Prej 1,130 trena sa kanë operuar në këtë periudhë raportuese, vetëm 18 prej tyre kanë shkaktuar këto vonesa siç shihen më poshtë:

Shkaku i vonesave	Minuta	Në përqindje
Lokomotiva HM	205	22.88
Vazhdimi i udhëtimit	132	14.73
Kryqëzimet	0	0.00
Lokomotiva / GM defekt	187	20.87
Lidhja me trenin	0	0.00
Bashkëngjitja e vagonëve. Tërheqja e mjeteve	0	0.00
Doganë + Polici	0	0.00
Pret në garniturë	0	0.00
Aksidente	66	7.37
Të tjera	306	34.15
Total vonesat	896	100

Tabela Nr. 4.4

V. DEPARTAMENTI I TRANSPORTIT TË MALLRAVE

V.1. Pasqyra e performancës operative

Në këtë pjesë të raportit do të paraqesim indikatorët fizik të performancës sonë operative gjatë periudhës gjashtëmujore nga 1 janari deri më 30 qershor 2018, duke prezantuar realizimin e detyrave në Departamentin e Transportit të Mallrave, krahasuar me planifikimin për periudhën raportuese si dhe duke krahasuar me realizimin e vitit paraprak 2017 për të njëjtën periudhë raportuese.

V.2. Rezultatet e arritura nga transporti i mallrave

Në Sektorin e Transportit të Mallrave për periudhën gjashtëmujore respektivisht nga 1 janari 2018 deri më 30 qershor 2018 kemi pasur këto rezultate:

Përshkrimi – Sasia e Transportuar	Janar – Qershor 2018
Realizimi Neto Ton në 2017	230,487.20 Ton
Realizimi Neto Ton në 2018	73,300.34 Ton
Planifikimi Neto Ton në 2018	300,375.00 Ton
Dallimi: Realizim 2018 – Realizim 2017	-157,186.86 Ton
Dallimi: Realizim – Planifikim në 2018	- 227,074.66 Ton
Dallimi: Realizim 2018 – Realizim 2017 (%)	31.80 %
Dallimi: Realizim 2018 – Planifikim 2018 (%)	24.40 %

Tabela 5.1

Siç mund të shihet nga tabela 1.1 në këtë periudhë kohore kemi transportuar për rreth 68.2% më pak se sa në të njëjtën periudhë raportuese të vitit të kaluar dhe 75.6% më pak se sa sasia e planifikuar për këtë periudhë.

Transporti i mallrave me kontejnerë për këtë periudhë gjashtëmujore ka qenë:

Përshkrimi – Numri i Transportuar i kontejnerëve	Janar – Qershor 2018
Kontejnerë të plotë - 2018	00.00 copë
Kontejnerë të zbrazët - 2018	00.00 copë

Tabela 5.2

Sasia e transportuar në Neto ton për periudhën Janar-Qershor 2018




Figura 5.1

Siç mund të shihet nga figura 1.1 në aspektin operativ kemi arritur të realizojmë vetëm 24.40 % nga planifikimi për gjashtëmuajorin janar – qershor 2018 .

V.3. Shfrytëzimi i Trenave

Në bazë të njoftimit nga Hekurudhat e Maqedonisë si dhe nga klientët, është bërë organizimi dhe planifikimi me kohë për arritjen e dërgesave nga stacioni kufitar deri në stacionin e shkarkimit. Gjithashtu edhe transporti vendor është realizuar sipas planifikimit.

Shfrytëzimi i trenave për periudhën Janar – Qershor 2018

Janar-Qershor 2018	Trena të shfrytëzuara	Trena të planifikuara	Shfrytëzim/Planifikim në % 2018
Import	24.00	181.00	13.25%
Export	18.00	181.00	9.94%
Vendor	87.00	362.00	24.03%
Total	129.00	724.00	17.81%

Tabela 5.3

V.4. Efektiviteti i Trenave

- Import - kemi 43.10 % efektivitet të trenave, pesha maksimale bartëse 1200 t/tren - mesatarja e çdo treni 418.04 bt.
- Eksport - kemi 21.69 % efektivitet të trenave, pesha maksimale bartëse 1200 t/tren - mesatarja e çdo treni 180.37 bt.
- Vendor - kemi 86.5% efektivitet të trenave, pesha maksimale bartëse 1300 t/tren - mesatarja e çdo treni 1100 bt.

V.5. Neto Ton & Neto Ton Kilometër të transportuar

Janar- Qershor 2018	Realizim	Planifikim	Realizim/Planifikimi 2018 në (%)	Neto ton kilometër	Humbje/fitim Planifikim/Realizim 2018
Neto ton - Import	7,545.63	21,026.21	36%	454,995	-13,480.58
Neto ton - Export	1,596.44	9,011.29	18%	106,329	-7,414.85
Neto ton - Vendor	64,158.27	270,337.47	24%	1,548,900	-206,179.20
Total:	73,300.34	300,375.00	24%	2,110,224	-227,074.66

Tabela 5.4

V.6. Mallrat e transportuara

Llojet e mallrave të transportuara gjatë kësaj periudhe kanë qenë: xehe e nikelit 89 %, gas 2 %, laminat 5 %, llamarinë 2%, gjips 1% si dhe mallra të përzieria 1% të cilat janë të paraqitura në figurën 1.2




Figura 5.2

VI. ZYRA E MIRËMBAJTJES SË MJETEVE LËVIZËSE - MML

VI.1. Pasqyra e performancës operative

Në këtë pjesë të raportit do të paraqesim performancën operative gjatë periudhës 1 janar 2018 – 30 qershor 2018, duke krahasuar atë me realizimin e gjashtëmujorit të parë të vitit 2017

VI.2. Sektori i mirëmbajtjes

Në fushën e sektorit të mirëmbajtjes së trenave motorikë, lokomotivave, lokomotivave manovruese, vagonëve për transportin e udhëtareve dhe vagonëve për transportin e mallrave gjatë periudhës kohore të raportimit prej 1.1.2018 deri më 30.6.2018 kemi pasur këto rezultate:

Matja e produktivitetit në shfrytëzimin e fuqisë punëtore

Matja e shfrytëzimit të fuqisë punëtore tregon se sa dhe ku shfrytëzohet më tepër fuqia punëtore dhe tregon raportin në mes fuqisë punëtore në dispozicion dhe fuqisë punëtore të shfrytëzuar

Shërbimi i mirëmbajtjes së lokomotivave gjatë periudhës janar - qershor ka disponua me fuqi pune prej 8602.5 orë ku:

2779 orë, janë shfrytëzua për riparim apo 32% e fondit total të orëve

932 orë, janë shfrytëzua për punë ndihmese dhe dytësore apo 11% e fondit total të orëve produktiviteti i tërë ka qenë 43%

Shërbimi i mirëmbajtjes së vagonëve gjatë periudhës janar - qershor ka disponua me fuqi pune prej 7411.5 orë ku:

1785 orë, janë shfrytëzua për riparim apo 24 % e fondit total të orëve

900 orë, janë shfrytëzua për punë ndihmese dhe dytësore apo 12% e fondit total të orëve produktiviteti i tërë ka qenë 36%

VI.2.1. Mirëmbajtja e trenave motorikë - TM

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e servisimeve, kontrollimeve dhe riparimeve për mirëmbajtjen e trenave motorikë të realizuara në periudhën janar - qershor 2018 krahasuar me periudhën janar - qershor 2017.

	Lloji i riparimit/mirëmbajtjes	janar - qershor 2018	janar - qershor 2017	Ndryshimi
1	Servisime	97	120	-23
2	Riparime	25	27	-2
3	Kontrollime K1	8	4	4
4	Kontrollime K3	2	0	2
5	Kontrollime K6	2	2	0
6	Gdhendja e rrotave	0	1	-1

Tabela 6.1

VI.2.2. Mirëmbajtja e trenave motorikë (TM) – matja e produktivitetit

Në trenat motorikë janë shpenzua gjithsej 1172 orë pune dhe atë:

Për servisim:	311 orë apo 27 % e orëve të shpenzuara për (TM)
Për riparim:	493 orë apo 42 % e orëve të shpenzuara për (TM)
Për kontrollim K1:	231 orë apo 29 % e orëve të shpenzuara për (TM)
Për kontrollim K3:	64 orë apo 6 % e orëve të shpenzuara për (TM)
Për kontrollim K6:	73 orë apo 6% e orëve të shpenzuara për (TM)

VI.2.3. Mirëmbajtjen e trenave motorikë (TM) – matja e efikasitetit

97 – servisime: koha mesatare për 1 servisim është 3.21 orë, gjashtë mujorin e 2017, ka qenë 3.29 orë

25 – riparime: koha mesatare për 1 riparim është 19.72 orë, gjashtë mujorin e 2017, ka qenë 35.04 orë

8 - kontrollim njëmujor K1: koha mesatare e një kontrollimi është 28.28 orë, gjashtëmujorin e 2017 ka qenë 28.75 orë

2 - kontrollim tremujor K3: koha mesatare e një kontrollimi është 32.00 orë, gjashtëmujorin e 2017 ka qenë 0 orë

2 - kontrollim gjashtëmujor K6: koha mesatare e një kontrollimi është 36.5 orë, gjashtëmujorin e 2017 ka qenë 35 orë.

VI.2.4. Mirëmbajtja e lokomotivave manovruese

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e servisimeve, kontrollimeve dhe riparimeve për mirëmbajtjen e lokomotivave manovruese të realizuara në periudhën janar - qershor 2018 krahasuar me periudhën janar - qershor 2017.

	Lloji i riparimit/mirëmbajtjes	janar - qershor 2018	janar - qershor 2017	Ndryshimi
1	Servisime	2	15	-13
2	Riparime	2	13	-11
3	Kontrollime K1	4	4	0
4	Kontrollime K3	1	0	1
5	Kontrollime K6	1	0	1

Tabela 6.2

VI.2.5. Mirëmbajtja e lokomotivave manovruese – matja e produktivitetit

Në lokomotivat manovruese janë shpenzua gjithsej 226 orë dhe atë:

Për servisimi: 15 orë apo 7 % e orëve të shpenzuara për lokomotiva manovruese

Për riparim: 54 orë apo 24 % e orëve të shpenzuara për lokomotiva manovruese

Për kontrollim: K1 – 105 orë apo 46 % e orëve të shpenzuara për lokomotiva manovruese.

Për kontrollim: K3 – 20 orë apo 9% e orëve të shpenzuara për lokomotiva manovruese

Për kontrollim: K6 – 32 orë apo 14% e orëve të shpenzuara për lokomotiva manovruese

VI.2.6. Mirëmbajtja e lokomotivave manovruese – matja e efikasitetit

Në lokomotivat manovruese janë kryer:

2 - servisime, koha mesatare për 1 servisim është 7.5 orë, në gjashtëmujorin e parë të vitit 2017 ka qenë 3.0 orë.

2 - riparime, koha mesatare për 1 riparim është 27.00 orë, në gjashtëmujorin e parë të vitit 2017 ka qenë 26.69 orë.

4 - kontrollim K1, koha mesatare për 1 kontrollim K1 është 26.25 orë, në gjashtëmujorin e parë të vitit 2017 ka qenë 27.5 orë.

1 - kontrollim K3, koha mesatare për 1 kontrollim K3 është 20.00 orë, në gjashtëmujorin e parë të vitit 2017 ka qenë 0 orë.

1 - kontrollim K6, koha mesatare për 1 kontrollim K6 është 32.00 orë, në gjashtëmujorin e parë të vitit 2017 ka qenë 0 orë.

VI.3. Mirëmbajtja e lokomotivave transportuese

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e servisimeve, kontrollimeve dhe riparimeve për mirëmbajtjen e lokomotivave transportuese të realizuara në periudhën janar - qershor 2018 krahasuar me periudhën janar - qershor 2017.

	Lloji i riparimit/mirëmbajtjes	janar - qershor 2018	janar - qershor 2017	Ndryshimi
1	Servisime	141	223	-82
2	Riparime	17	31	-14
3	Kontrollime K1	13	18	-5
4	Kontrollime K3	3	5	-2
5	Kontrollime K6	3	5	-2
6	Gdhendje te rrotave	1	0	1

Tabela 6.3

VI.3.1 Mirëmbajtja e lokomotivave transportuese – matja e produktivitetit.

Në lokomotivat transportuese janë shpenzua 1380 orë dhe atë:

Për servisime: 404 orë apo 29% e orëve të shpenzuara për lokomotiva transportuese,

Për riparim: 279 orë apo 25% e orëve të shpenzuara për lokomotiva transportuese,

Për kontrollim K1: 435 orë apo 32% e orëve të shpenzuara për lokomotiva transportuese,

Për kontrollim K3: 98 orë apo 7% e orëve të shpenzuara për lokomotiva transportuese,

Për kontrollim K6: 156 orë apo 11 % e orëve të shpenzuara për lokomotiva transportuese,

Për gdhendje të rrotave: 8 orë apo 0.58 % e orëve të shpenzuara për lokomotiva t transportuese.

VI.3.2 Mirëmbajtjen e lokomotivave transportuese – matje e efikasitetit

Efikasiteti i arritur gjatë periudhës janar - qershor në mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse te lokomotivat transportuese janë kryer:

141 - servisime, koha mesatare për 1 servisim është 2.87 orë, gjashtëmujorin e parë të vitit 2017 ka qenë 2.9 orë,

17 - riparime, koha mesatare për 1 riparim është 16.41 orë, gjashtë mujorin e parë të vitit 2017 ka qenë 32.55 orë,

13 - kontrollime një mujore K1, koha mesatare e një kontrollimi është 33.46 orë, gjashtëmujorin e parë të vitit 2017 ka qenë 31.78 orë,

3 - kontrollime tre mujore K3, koha mesatare e një kontrollimi është 32.67 orë, gjashtëmujorin e parë të vitit 2017 ka qenë 39.20 orë,

3 - kontrollime gjashtë mujore K6, koha mesatare e një kontrollimi është 52.00 orë, gjashtëmujorin e parë të vitit 2017 ka qenë 43.60 orë,

1 – gdhendje të rrotave, koha mesatare e një kontrollimi është 8.00 orë, gjashtëmujorin e parë të vitit 2017 ka qenë 0 orë.

Intervenimet në mjetet tërheqëse gjatë periudhës 1.1.2018 deri më 30.6.2018 për secilin mjet kanë qenë:

Lo ko mo ti va. Nr.	2640 001	2640 002	2640 003	2640 004	2620 005	2640 006	2640 007	2640 008	2710 009	2640 010	2620 016	2760 001	2760 002	5800 001	5800 002
S					23		23	6	2	1	86	2		53	44
R					5		1	2			8	2	1	6	18
K 1					4		4	1	1		4	4		4	4
K 3					1		1				1	1		1	1
K 6					1		1				1	1		1	1

Tabela 6.4

VI.4. Mirëmbajtja e vagonëve për transportin e udhëtarëve

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e testimeve të komponentëve, kontrollimeve dhe riparimeve për mirëmbajtjen e vagonëve të udhëtarëve të realizuara në periudhën janar - qershor 2018 krahasuar me periudhën janar - qershor 2017.

	Lloji i riparimit/mirëmbajtjes	janar - qershor 2018	janar - qershor 2017	Ndryshimi
1	Kontrollime K1	58	42	16
2	Riparime në punëtori	12	8	4
3	Kontrollime në stacion	181	181	0
4	Gdhendje të rrotave	0	2	-2

Tabela 6.5

VI.4.1. Mirëmbajtja e vagonëve për transportin e udhëtarëve – matja e produktivitetit

Në vagonët e udhëtarëve janë shpenzua 1540 orë dhe atë:

Për kontrollime K1, 1160 orë apo 75% e orëve të shpenzuara për mirëmbajtjen e vagonëve të udhëtarëve;

Për riparim 23 orë apo 2% e orëve të shpenzuara për mirëmbajtjen e vagonëve të udhëtarëve;

Për kontrollim në stacion 355 orë apo 23% e orëve të shpenzuara për mirëmbajtjen e vagonëve të udhëtarëve.

VI.4.2. Mirëmbajtja e vagonëve për transportin e udhëtarëve – matja e efikasitetit

Në vagonët e udhëtarëve janë kryer;

58 - kontrollime mujore K1, koha mesatare për një kontrollim mujor është 20.0 orë, gjashtë mujorin e parë të vitit 2017 ka qenë 20.0 orë.

12 - riparime në punëtori, koha mesatare për 1 riparim në punëtori është 1.91 orë, gjashtëmujorin e parë të vitit 2017 ka qenë – 4.13 orë.

181 - riparime në stacion, koha mesatare për 1 riparim në stacion është 1.96 orë, gjashtëmujorin e parë të vitit 2017 ka qenë 2.01 orë.

VI.5 Mirëmbajtja e vagonëve për transportin e mallrave

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e testimeve të komponentëve, kontrollimeve dhe riparimeve për mirëmbajtjen e vagonëve të mallrave të realizuara në periudhën janar - qershor 2018 krahasuar me periudhën janar - qershor 2017.

	Lloji i riparimit/mirëmbajtjes	janar - qershor 2018	janar - qershor 2017	Ndryshimi
1	Kontrollime K3	22	52	-30
2	Riparim në punëtori	1	11	-10
3	Riparim në teren	0	1	-1
4	Testim të komponenteve	0	0	0
5	Gdhendje të rrotëve	0	1	-1

Tabela 6.6

VI.5.1. Mirëmbajtja e vagonëve për transportin e mallrave – matja e produktivitetit

Në vagonët e mallrave janë shpenzua 243 orë dhe atë

Për kontrollime K3 - 239 orë apo 98% e orëve të shpenzuara për mirëmbajtjen e vagonëve të mallrave

Për riparime në punëtori 4 orë apo 2% e orëve të shpenzuara për mirëmbajtjen e vagonëve të mallrave

VI.5.2. Mirëmbajtja e vagonëve për transportin e mallrave – matja e efikasitetit

Në vagonët e mallrave janë kryer:

22- kontrollime tre mujore K3, koha mesatare për 1 kontrollim tre mujor K3 është 10.86 orë, gjashtë mujorin e 2017 ka qenë 15.15 orë.

1 - riparim në punëtori, koha mesatare për 1 riparim në punëtori është 4.0 orë, gjashtëmujorin e parë të vitit 2017 ka qenë 4.18 orë.

VI.5.3. Faturimet për riparimin e vagonëve të huaj për periudhën janar qershor 2018

Vagonët e NewCo Ferronikeli:

Janar - Qershor 2018 është 3519 €,

Janar - Qershor 2017 është 7830 €

VI.6. Shpenzimet e vajrave për periudhën kohore janar - qershor 2018

Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Σ
Vaj llokomoll HS 40	480	925	710	280	190	300	2885
Antifriz	225	650					875
Vaj ATF		2	3	2	8	297	312
Vaj SAE 15/40		60	60	40	20	303	483
Vaj SAE 30	5				12		17
Vaj EP 90		7	44	80	10		141
Vaj kompresori		20			10		30

Tabela 6.7

VI.7. Buxheti

Në vazhdim është dhënë tabela ku prezantohen kërkesat për buxhetim të mjeteve si dhe buxheti i pa shfrytëzuar.

	Vijat buxhetore	Kodi	Njësit buxhetore	Buxheti vjetor	Buxheti gjashtë mujor	Kërkesat	Mbetja nga buxheti gjashtë mujor	Mbetja e tërë
Derivat dhe lubrifikant								
1	Vaji për mjete lëvizëse	60103	Lok/tm	40,000.00	/	12,711.30	/	27,288.70
			Vagonët	500.00	/	0	/	500.00
	Gjithesejt			40,500.00		12,711.30		27,788.70
Pjesë rezervë, materiale të tjera								
1	Blerje materiale të tjera	60121	Lok/tm	2,400.00	1200.00	320.00	880.00	2,080.00
			Vagonët	2,400.00	1,050.00	141.00	909.00	2,259.00
2	Pjesë ndërrimi	60122	Lok/tm	45,000.00	24,400.00	15,410.00	8,990.00	29,590.00
			Vagonët	6,800.00	2,850.00	0	2,850.00	6,800.00
3	Material për njësit e transportit	60123	Lok/tm	3,600.00	1,800.00	196.00	1,604.00	3,404.00
			Vagonët	3,000.00	1,300.00	0	1,300.00	3,000.00
4	Mirëmbajtje dhe riparime për makina	60124	Lok/tm	6,000.00	2,700.00	644.00	2,056.00	5,356.00
			Vagonët	3,300.00	2,700.00	0	2,700.00	3,300.00
	Gjithësej			72,500.00	38,000.00	16,711.00	21,289.00	55,789.00

Tabela 6.8

VII. PROJEKTET KAPITALE

Nr	Titulli i Aktivitetit te Prokurimit	Kontraktuar	Buxheti i zotuar	Vlera e kontrates	Koment
1	Shërbimet e sigurimit fizik të objekteve të Trainkos Sha TRA/17/068/221	Janar	45,000.00	46,444.80€	Në vazhdim
2	Furnizim me naftë për nevojat e Trainkos Sha TRKOS/18/01/111	Mars	1,400,000.00	1,400,000	Në vazhdim
3	Furnizimi me material hixhienik TRKOS/18/03/136	Mars	5,500.00	4,663.80€	Në vazhdim
4	Furnizim me material administrativ TRA/18/04/136	Mars	5,500.00	5,048.10€	Në vazhdim
5	Furnizimi dhe montimi i dizel motorit te gjeneratorit 55kw		4,000.00		Përfunduar
6	Renovimi i objektit te tërheqjes se trenave TRA/17/061/521	Tetor 2017	200,000.00	180,414.00€	Përfunduar
7	Mbikëqyrja e projektit "Renovimi i objektit te tërheqjes se trenave" TRA/075/236	Tetor 2017	4,000.00	950.00€	Përfunduar
8	Sigurimi i palëve te treta	Shkurt	2,000.00	1,650.00	Në vazhdim
9	Furnizimi me tonera TRKOS/18/02/136	Shkurt	5,000.00	4,224.50€	Në vazhdim
10	Furnizim me pjesë për gjenerator të lokomotivës 2620 - 005 TRKOS/18/15/136		2,100.00		
11	Riparimi i lokomotivës manovruese	Qershor	20,000.00	16,500.00	Përfunduar
12	Riparimi dhe atestimi i vinçave të trenit ndihmës	Qershor	16,000.00	15,360.00	Përfunduar
13	Shërbimet e sigurimit të automjeteve	Maj	2,000.00	1,607.61	Në vazhdim
14	Furnizimi me rollne për arkat fiskale të llojit DP 05	Maj	3,000.00	2,238.00	Në vazhdim
15	Riparimi gjeneral i transmetuesve hidraulik te TM Y1		30,000.00		
16	Furnizimi dhe montimi i vinçave dhe mjeteve tjera	Maj	122,000.00	121,634.00	Në vazhdim
17	Shërbim konsulence për matjen e kënaqshmërisë së klientëve – Trainkos Sh.A. TRA/17/36/236		2,000.00		
18	Furnizimi me pjesë për vetura		6,003.00		
19	Furnizimi me papuçe frenuese		12,000.00		
20	Punë shtesë në projektin renovimi i objektit të tërheqjes se trenave	Maj	11,400.00	11,359.49	Përfunduar

Tabela Nr. 7.1

VIII. KONTESTET GJYQËSORE

Gjatë periudhës janar - qershor 2018 janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme më qëllim të përfaqësimit, ruajtjes, mbrojtjes së interesave të Ndërmarrjes, dhe asistimin në mbikëqyrjen e hartimit dhe implementimit të Rregulloreve dhe akteve juridike të aplikueshme në HK-Trainkos-Sh. A.

Ndërmarrja në vazhdimësi është ballafaquar me probleme të natyrave të ndryshme rreth ruajtjes së interesave të saj, sidomos sa i përket çështjeve që kanë të bëjnë me kontestet nga kompensimi i dëmeve.

VIII.1. Kontestet për kompensim dëmi

Nga kontestet e kompensimit të dëmeve gjatë periudhës janar – qershor 2018 kemi mbajtur njëmbëdhjetë (11) seanca gjyqësore, ndërsa në procedurë gjyqësore kemi pasur pesë (5) konteste.

Nr.	Nr. i lëndës	Vlera euro (€)	Trainkos Sh. A në cilësinë e palës:
1.	IV.C.nr.381/15	16,703.00 €	Paditëse
2.	C.nr.1145/15	166,500.00 €	E paditur
3.	C.nr.1111/13	4,500.00 €	E paditur
4.	III.EK.nr.155/16	10,742.00 €	Paditëse
5.	C.nr. 155/14	4,000.00 €	E paditur

Tabela Nr. 8.1

Gjatë këtij gjashtëmujori nga gjyqësori i Kosovës për kontestet e kompensimit të dëmeve kemi pranuar dy aktgjykime të formës së prerë dhe një aktgjykim të shkallës së parë.

VIII.2. Aktgjykimet

Nr.	Nr. lëndës	Vlera €	Trainkos Sh. A në cilësinë e palës:	Veprimet e ndërmarra
1.	Ac.nr.2356/13	2,930.00 €	E paditur	Është ushtruar Revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës në bazë të aktgjykimit të formës së prerë.
2.	C. nr. 286/09	100.000.00 €	E paditur	Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Gillogoc në favor të Ndërmarrjes.
3.	Ac.nr.1169/14	1,368 € +808,40 €	E paditur	Është kompensuar dëmi në bazë të aktgjykimit të plotfuqishëm.

Tabela Nr. 8.2

VIII.3. Kontestet për pagim borxhi

Nga kontestet e borxhit gjatë periudhës kohore janar – qershor 2018, HK - Trainkos - Sh. A. ka pranuar dy aktgjykime dhe dy aktvendime.

VIII.4. Aktgjykimet

Nr.	Nr. lëndës	Vlera €	Trainkos Sh. A në cilësinë e palës:	Veprimet e ndërmarra
1.	I.EK.nr.221/15	55,500.00 €	Paditëse	Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Ekonomik në favor të Ndërmarrjes. Lënda në Gjykatën e Apelit në Prishtinë.
2.	Ac.nr.99/2016	6,679.93 €	E paditur	Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në Prishtinë në disfavor të Ndërmarrjes. Është përmbushur detyrimi në vlerë prej 8,492.42 €.

Tabela Nr. 8.3

VIII.5. Aktvendimet

Nr.	Nr. lëndës	Vlera €	Trainkos Sh. A në cilësinë e palës:	Veprimet e ndërmarra
1.	PPP.nr.685/17	2,342.00 €	Debitor	Është ushtruar ankesë, lënda gjendet në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, është bërë pagesa e garancionit në vlerë 2,342.00 €.
2.	P.nr.976/17	224,318.20 €	Debitor	Është ushtruar prapësim, lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prishtinë.
3.	Rev.nr.8/2018	6,679.93 €	Debitor	Lënda e përfunduar

Tabela Nr. 8.4

VIII.6. Kontestet e punës

Nga kontestet e punës gjatë periudhës janar - qershor 2018 kemi mbajtur katër (4) seanca gjyqësore, ndërsa në procedurë gjyqësore kemi pasur tri (3) konteste.

Nr.	Nr. i lëndës	Vlera euro (€)	Trainkos Sh. A në cilësinë e palës:
1.	C.nr.607/14		E paditur
2.	C.nr.291/17	41,500.00 €	E paditur
3.	C.nr.1069/17	49,895.12 €	E paditur

Tabela Nr. 8.5

Sa i përket kontesteve të punës në këtë gjashtëmuor kemi pranuar katër aktgjykime dhe një aktvendim.

VIII.7. Aktgjykimet

Nr.	Nr. lëndës	Vlera €	Trainkos Sh. A në cilësinë e palës:	Veprimet e ndërmarra
1.	C. nr. 1069/17	49,895.12 €	E paditur	Është aprovuar kërkesëpapia e paditësit. Pritet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit sipas ankesës së të paditurës
2.	C.nr.291/17	41,500.00 €	E paditur	Është refuzuar kërkesëpapia e paditësit. Pritet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit sipas ankesës së paditësit
3.	C.nr.607/14		E paditur	E përfunduar në favor të Ndërmarrjes në shkallë të parë.
4.	Rev.nr.272/2017	270.00 €	E paditur	E përfunduar në favor të Ndërmarrjes.

Tabela Nr. 8.6

VIII.8. Aktvendimet

Nr.	Nr. lëndës	Vlera €	Trainkos Sh. A në cilësinë e palës:	Veprimet e ndërmarra
1.	Rev.nr.234/17		E paditur	Lëndë e përfunduar në favor të Trainkos Sh. A.

Tabela Nr. 8.7

Duhet cekur se gjatë kësaj periudhe nga kontestet e punës që kanë qenë në procedurë një kontest ka përfunduar në favor të Trainkos Sh. A sipas aktgjykimit të plotfuqishëm C. nr. 607/2014 Gjatë kësaj periudhe kemi në kontestet e punës kemi pranuar një padi të re.

Nr.	Nr. lëndës	Vlera €	Trainkos Sh. A në cilësinë e palës:	Veprimet e ndërmarra
1.	C.nr.254/18	Paga jubilarë	E paditur	Është përgatitur përgjigje në padi .

Tabela Nr. 8.8

VIII.9. Lëndët përmbaremore

Sa i përket lëndëve në procedurë përmbaremore HK - Trainkos - Sh.A. gjatë periudhës janar - qershor 2018 në procedurë ka pasur pesë (5) lëndë, ku në katër (4) prej tyre HK-Trainkos-SH.A. është në cilësinë e debitorit ndërsa vetëm në një (1) lëndë ka cilësinë e kreditorit dhe atë në procedurë të kundërpërmbaremit.

Nr.	Nr. i lëndës	Vlera euro (€)	Trainkos Sh.A në cilësinë e palës:	Veprimet e ndërmarra
1.	PPP.nr.864/2017	125,521.95 €	Debitor	Është ushtruar ankesë, lënda gjendet në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, është bërë pagesa e garancionit në vlerë 125,522.00 €.
2.	P.nr.173/2017	827,259.27 €	Debitor	Është ushtruar prapësim, lënda

				gjendet në Gjykatën Themelore në Prishtinë.
3.	P.nr.976/2017	224,318.20 €	Debitor	Është ushtruar prapësim, lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prishtinë.
4.	P.nr.111/2018	4,705.82 €	Debitor	Është ushtruar prapësim, lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prishtinë.
5.	Rev.272/2017	270.00 €	Kreditor	Është ushtruar propozim për kundër përmbarrim në bazë të aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Tabela Nr. 8.9

VIII.10. Aktvendimet

Nr.	Nr. lëndës	Vlera €	Trainkos Sh.A në cilësinë e palës:	Veprimet e ndërmarra
1.	PPP.nr.684/17	3,852.00 €	Debitor, Comando Shpk	Është refuzuar prapësimi i ushtruar nga Trainkos Sh..A. lënda gjendet në shkallë të dytë sipas ankesës.

Tabela Nr. 8.10

Prej lëndëve përmbarrimore duhet cekur faktin se për momentin ekziston rreziku i përmbarrimit-ekzekutimit të lëndëve përmbarrimore nga Kreditorit Infracos Sh. A. në vlerën prej 827,259.27 €, lëndë kjo e cila gjendet në procedurë në Gjykatën Themelore në Prishtinë sipas prapësim, përkatësisht ankesës të ushtruar nga debitori HK – Trainkos - Sh. A,

Në bazë të kësaj gjendjeje, kontestet gjyqësore kanë qenë dhe mbesin si një ndër rreziqet më të mëdha të kompanisë pasi që numri më i madh i tyre është trashëguar nga ish - Hekurudhat e Kosovës me ç'rast janë bërë shkelje të procedurave ligjore sa i përket çështjes së kontesteve të punës çka ekziston rrezik potencial që ndonjë kontest të përfundojë në disfavor të Trainkos Sh. A. e kjo si pasojë e menaxhimit jo të mirë të kompanisë sa ishte nën administrim të UNMIK-ut.

IX. AKTIVITETET NË PLANIFIKIMIN DHE ZHVILLIMIN E BIZNESIT

Departamenti për Zhvillim e Biznesit në periudhën Janar – Qershor 2018 ka zhvilluar aktivitete sipas obligimeve që rrjedhin nga përshkrimi i vendeve të punës për këtë Departament, Planit të Biznesit për vitin 2018 dhe Planit të Punës. Po ashtu gjatë periudhës raportuese janë kryer edhe detyra tjera që dalin sipas nevojës dhe kërkesave të Menaxhmentit. Aktivitetet më të rëndësishme për periudhën Janar-Mars janë të specifikuar më poshtë:

1. Planifikimi dhe Zhvillimi i Biznesit;
2. Koordinimi i proceseve me ARH-në dhe Institucionet tjera;
3. Aktivitet e Marketingut;
4. Raportimi i rregullt vjetor në Asociacionet tjera Hekurudhore;

IX.1. Planifikimi dhe Zhvillimi i Biznesit

Gjatë periudhës raportuese kemi realizuar aktivitete të shumta për të siguruar mbështetje në hartimin e një Plani Biznesi afatmesëm (3 apo 5 vjeçar) tek IFN-të (Institucionet Financiare Ndërkombëtare) dhe mistria/ministritë përkatëse brenda Qeverisë së Kosovës. Kontaktet e vazhdueshme me BERZh-in (Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim) kanë rezultuar me konkretizim të kërkesës sonë për mbështetjen financiare të një Asistence Teknike që TRAINKOS-it do të i mundësonte përgatitjen e Plani të Biznesit paralel me zhvillimet tjera në sektor.

Angazhimi jonë gjatë këtij 6 mujori është mbështetur në planifikimet strategjike që ka shteti i Kosovës dhe zbërthimi i këtyre strategjive në plane të veprimit. Synimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës është që me shfrytëzimin e mundësive që ofrojnë IFN-të dhe Bashkësia Evropiane (BE) me mekanizmat e sajë të bëhet fillimisht investimi në Linjat ekzistuese hekurudhore, pastaj të vazhdohet me Linjat tjera të reja të identifikuar me “Strategjinë Sektoriale dhe Transportin Multimodal 2015 – 2025 dhe Plani i veprimit 5 vjeçar”. Mbështetja konkrete e BE dhe mekanizmave që ka krijuar BE-ja ka ndodhur në proceset e përgatitjes dhe investimit në projektin “Rehabilitimi i Linjës së 10-të hekurudhore” Hani i Elezit – Leshak

Veprimet e domosdoshme afatshkurta për zhvillimin e sektorit hekurudhorë janë dhe kërkesa të BE-së për zbatim të përfshira në strategjinë e përgatitur për shtetet e Evropës Jug – Lindore. Kushtet të cilat do të ndikojnë në zhvillimin e transportit hekurudhorë janë: Ratifikimi i Traktatit për Transport, finalizimi i marrëveshjes ndërkufitare me Republikën e Maqedonisë dhe sigurimi i mjeteve financiare të domosdoshme për mirëmbajtjen e linjave hekurudhore. Për sektorin hekurudhorë do të avancohet baza legjislative sipas nevojave gjatë proceseve, për operatorin shtetërorë të sigurohen në kohë të përshtatshme mjete financiare përmes IFN-ve për blerjen e mjeteve lëvizëse adekuate me modernizim e Linjave hekurudhore, sigurohen punëtoritë adekuate

për servisim dhe riparim të mjeteve lëvizëse dhe angazhimi për anëtarësim në asociacionet hekurudhore Evropiane.

Në vazhden e mbështetjes së sektorit hekurudhor nga BE-ja përmes mekanizmave të krijuar dhe raporteve të SEETO-s për Evropën Jug – Lindore ka filluar projekti përmes CONNECTA-s në shtator 2017, në periudhën raportuese janë mbajtur katër takime që kanë rezultuar me përgatitjen dhe aprovimin në nivele teknike por edhe me prezantim final para TRAINKOS-it, INFRAKOS-it, ARH-së dhe MI-së, e që ka të bëjë me formulën më të mirë dhe propozimet optimale (skenarë të ndryshëm optimist) për transportin e udhëtarëve dhe të mallrave. Ky projekt i rëndësishëm që ka zgjatë një vit e gjysmë duhet të zbatohet menjëherë nëse e kemi parasysh kohën e nevojshme që planifikimet të inkorporohen në planet afatmesme dhe afatgjata për Kosovën si shtet i Ballkanit Perëndimorë si dhe secilin shtet nga kjo pjesë e Evropës veç e veç.

Transporti i xehes, lëndës finale dhe thëngjillit për NewCo Ferronikeli nga eksporti, importi dhe transporti minierë – punëtori në Drenas ka stagnuar nëse e kemi parasysh problemet me të cilat është duke u ballafaquar kjo kompani dhe moszbatimi i transportit sipas kontratës për vitin 2018, mirëpo marrë parasysh kontaktet e vazhdueshme që kemi, presim që ky transport të rikthehet, shumë shpejt.

Kontaktet e rregullta me partnerët regjional, kryesisht me ata të Republikës së Maqedonisë janë të përqendruara në krijimin e mundësive për të rritur transportin. Periudha raportuese përfshinë edhe angazhimin e vazhdueshëm për të diskutuar dhe përfutur nga ofrimi i mundësive për transportin e lëndës finale - Cement, Transportin e xehes që vjen nga Kukësi (Shqipëri) në drejtim të Kavadarci (Maqedoni), transportin e kontejnerëve nga Porti Pireus (afër Athinës, Greqi), transporti i derivateve të naftës nga OKTA, transporti i xeheve dhe mineraleve potencial nga proceset e dhënës së licencave nga AKP-ja, etj.

Problemet e transportit me hekurudhë deri në Portin e Selanikut vazhdojnë, klientët potencialë kanë gjetur zgjidhje në forma tjera të transportit dhe kthimi i tyre është sfidë në vete dhe kërkon angazhim plotësues për t'i kthyer mbrapa transportin nga ky Port, kryesisht kur destinacioni final është në territorin e Kosovës. Për një kthesë pozitive nevojitet edhe angazhimi i Aksionarit – MZHE-së dhe subjekteve tjera brenda Qeverisë që merren me politika dhe financim të sektorit hekurudhor.

Periudha raportuese ka rezultuar me finalizimin e procesit të përgatitjes për nënshkrim të Marrëveshjes së OShP-së 2018 – 2022 dhe fillimit të zbatimit të saj. Vonesat në këtë proces rezultojnë në problemet organizative dhe financiare që mund dhe po ndeshet TRAINKOS-i. Me fillimin e zbatimit të kësaj Marrëveshje, sidomos pas analizës për periudhën raportuese vërehet se funksionimi i trenave të aprovuar nuk do të përmbyll vitin 2018 me shumën e buxhetuar fillimisht, nëse MI nuk do të sigurojë mjetet për pjesën tjetër të vitit do të përsëritet viti 2017 dhe problemet me likuiditet për TRAINKOS-in.

IX.2. Koordinimi i proceseve me ARH-në dhe Institucionet tjera.

Periudha raportuese rezulton me angazhimin e vazhdueshëm në plotësimin e obligimeve në raport me Ministrinë e Infrastrukturës (MI), ARH-në, Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik (MZhE); ESK (Enti Statistikor i Kosovës) dhe BERZh.

- Gjatë periudhës raportuese është bërë koordinimi dhe zhvillimin e aktiviteteve në përgatitjen e raportit narrativ për DPSA – kuarteti i parë 2018 që ka rezultuar me takimin e Brukselit, raport që përmban kritika të rrepta në zbatimin e Ligjit për Hekurudha, sidomos në mosfunksionimin e Marrëveshjes së OShP-së dhe problemet me shkurtimin e linjave të transportit të udhëtarëve;
- ARH, konkretisht Departamenti i Rregullimit të Tregut duke u bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë që ka, ka kërkuar dhe është informuar në periudha të rregullta për proceset e diskutimit dhe nënshkrimit të Marrëveshjes së OShP-së 2018 – 2022 me Ministrinë e Infrastrukturës;
- Departamenti i Rregullimit të Tregut duke u bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë që ka, është furnizuar me statistika zyrtare për transportin e mallrave dhe udhëtarëve në periudha të rregullta mujore;
- Gjatë periudhës raportuese jemi pajisur me Certifikatën e Sigurisë (A dhe B) për periudhën 5 vjeçare 2018-2022.
- Enti Statistikor i Kosovës është furnizuar me statistika zyrtare për transportin e mallrave dhe udhëtarëve në periudha të rregullta raportuese;
- Është finalizuar dokumenti “Manualit për makinistët” i cili është dërguar për procedim të mëtutjeshëm;
- Përmes SEETO-s për procesin e monitorimit të Raportit të Progresit janë plotësuar kërkesat sipas pyetësorëve të kërkuar dhe në këtë periudhë kemi rishikuar avancimet në procesin e “masave të buta” për vitin 2018 që janë bazë për zbatim dhe kërkesa për zhvillim dhe avancim. Ngecjet në zbatimin e Marrëveshjes së OShP-së janë brengë e cila është e ngritur me faktorin ndërkombëtarë, posaçërisht me Bashkësinë Evropiane përmes mekanizmave të krijuar për këtë qëllim;
- Kërkesa e zyrtarëve nga ESK (Enti i Statistikave të Kosovës) për plotësimin e pyetësorit sipas kërkesave të EUROSTAT-it është plotësuar nga ana e TRAINKOS-it

IX.3. Aktivitet e Marketingut

TRAINKOS SH. A. edhe gjatë këtij gjashtëmujori ka vazhduar me përmbushjen e obligimeve të dala nga Plani i Biznesit dhe Plani i Punës i Departamentit të Biznesit për monitorimin dhe vizitat e rregullta drejt klientëve të rregullt duke qenë afër tyre për shqyrtimin e çdo ankese apo kërkesë që kanë në drejtim të kompanisë.

Në kuadër të vizitave drejtim klientëve potencialë është përgatitur një listë me klientët kryesor potencialë, listë e cila është aprovuar nga menaxhmenti i kompanisë, dhe bazuar në këtë janë realizuar vizita të drejtpërdrejta për shqyrtimin e mundësisë për realizimin e transportit me Hekurudhë, tek shumë kompani në Kosovë të cilat importojnë dhe eksportojnë mallra të ndryshme në dhe nga Kosova.

Po ashtu gjatë këtij gjashtëmujori nuk kanë munguar edhe aktivitetet në rrjetet sociale, duke prezantuar shërbimet tona në transportin e mallrave dhe në transportin e udhëtarëve.

IX.4. Raportimi i rregullt vjetor në Asociacionet tjera Hekurudhore

Raportimet e rregullta në CIT (International Rail Transport Committee) vazhdojnë të bëhen. Edhe në vitin 2018 aktivitetet në gjetjen e modalitete për t'u anëtarësuar në asociacionet hekurudhore ndërkombëtare vazhdojnë të ndodhin. Vlen të përmendet se kjo ende po varet nga politikat shtetërore të cilat po zhvillohen dhe gatishmëria e institucioneve relevante qeveritare për të vepruar në këtë drejtim. Kjo temë dhe shume çështje tjera që kanë të bëjnë me TRAINKOS-in janë diskutuar edhe me Drejtorin e CER-it (Komuniteti Hekurudhor Evropian) në takimin vjetorë të mbajtur në Prishtinë, ku fokus i veçantë i është dhënë planifikimeve dhe projektet strategjike të BE-së për shtete e Evropës Jug – Lindore (Ballkani Perëndimor).

Duke pasur parasysh që Kosova ende nuk është anëtarësuar në asociacione të ndryshme ndërkombëtare, kjo ka bërë që mos të kemi raportime tjera pasi që nuk pranojmë kërkesa apo obligime ligjore për një gjë të tillë.

X. SFIDAT KRYESORE GJATË PERIUDHËS JANAR – QERSHOR 2018 DHE VEPRIMET PËR TË ARDHMEN

Gjatë periudhës Janar - Qershor 2018 si edhe viteve tjera kompania ka vazhduar të ballafaqohet me shumë sfida si në vijim:

1. Mos respektimi i Ligjit të Hekurudhave të Kosovës Nr. 04 / L-076 për mbulimin e shpenzimeve për OSHP, nënshkrimi i Marrëveshjes për OShP 2018 – 2022 më 18.04.2018 kufizon linjat në minimum dhe sipas planifikimeve në KASh 2018 – 2021 nuk parashihet ndonjë zhvillim / reformë në këtë lloj të transportit publik;
2. Mungesa e ligjit për sigurinë në komunikacionin hekurudhor;
3. Proceset e shumta gjyqësore të trashëguara nga ish Hekurudhat e Kosovës;
4. Mos funksionimi i të gjitha linjave hekurudhore;
5. Vonesat në realizimin e projektit “Modernizimi i Linjës së 10-të hekurudhore” si infrastrukturë bazë që bën lidhjen me pjesën tjetër të Evropës (infrastrukturë dhe reforma të sektorit hekurudhor);
6. Mos zbatimi i bazës ligjore në sektorin e transportit dhe lejimi i konkurrencës jolojale;
7. Licencimi dhe futja në treg e operatorit hekurudhor privat, pa ndonjë analizë të mirëfilltë të tregut nga ana e institucioneve relevante;
8. Gjendja jo e mirë e mjeteve lëvizëse për shkak të vjetërisë së tyre dhe kostoja e lartë investuese;
9. Mungesa e një “Master Plani afatmesëm” për TRAINKOS-in;
10. Neglizhenca e institucioneve relevante të cilat veprojnë në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës në inkorporimin e operatorit shtetërorë në planifikimet strategjike për zhvillim industrial të vendit;
11. Mos funksionimi normal (sipas planifikimeve) i klientit kryesorë në transportin e mallrave;
12. Moshë mesatare e lartë e personelit ekzekutiv.

Duke pasur parasysh që sfidat e lartcekura janë të natyrave të ndryshme dhe kërkojnë përkrahje edhe nga shumë institucione relevante, kompania është munduar në vazhdimësi që këto

sfida/probleme t'i paraqes dhe të kërkojë zgjidhje/mbështetje, mirëpo marr parasysh karakterin e tyre ka qenë e pamundur arritja e rezultateve pozitive duke rezultuar edhe me mos përmirësimin e përgjithshëm të kompanisë.

Mbesim të përkushtuar dhe insistojmë në vazhdim që të gjitha këto probleme të trajtohen nga institucionet dhe faktorët tjerë relevant në mënyrë që të marrim zgjidhjen e duhur, me qëllim të zhvillimit të ndërmarrjes si aset shtetëror.

Për sfidat e precizuara më lart përgjegjësit në kompaninë Hekurudhat e Kosovës - TRAINKOS Sh. A. sipas planifikimeve mbesin të përkushtuar në angazhimin maksimal në arritjen e realizimit të objektivave.



Gelor Shala
Kryeshef Ekzekutiv

Fushë Kosovë,

Korrik 2018